

Studentët nga Kosova do të marrin pjesë në garën studimore në Vjenë

"Rasti sfidues i Kosovës 2008" këtë vit sjell risi

Është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete, si dhe të vlerësohet sesa janë ata të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës, tha But Dedaj, drejtor i organizatës "Vus-Austria"

Besa Bytyçi

Organizata për edukim "Vus Austria", për herë të katër këtë vit, organizon garën "Rasti sfidues i Kosovës 2008" me mbështetjen e Agjencisë Austriake të Kooperimit.

But Dedaj, drejtor i "Vus-it" tha se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e arsimit të lartë në Kosovë që ndodhen në vitin e fundit të studimeve, apo vijnë studimet master. Por, sipas tij, nuk iu mohohet e drejta e konkurrencës as studentëve të

viteve paraprake që kanë sukses të dalluar dhe njohin gjuhën angleze, e cila është kriter për pjesëmarrje në këtë garë. "Kjo është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete si dhe të vlerësohet sesa janë ata të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës".

Dedaj bëri të ditur se këtë herë do të përdoret dhe një metodë e re. Sipas tij, nga përfaqësues të kompanive private e publike që janë partner në organizimin e kësaj gare, studentëve garues do t'u prezantohet një problem i cilës-

do kompani dhe gjatë dy ditëve studentët do të kenë rast të japin idenë e tyre se si do të dilet nga problemi. "Kjo gjë do të ndikojë pozitivisht në punësimin e tyre në atë kompani apo mbulimin e studimeve master", tha ai.

Për dallim nga viti i kaluar, kësaj radhe kjo garë do të përbëhet nga tri pjesë; trajnimi për aplikues, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për rastin sfidues të Ballkanit që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit (punësimit). Ndërkaq gara do të zhvillohet në katër disiplina garuese; simulim gjyqi, biznes, mod-

eli i Këshillit të Evropës që zëvendëson modelin e Kombeve të Bashkuara të viteve të kaluara dhe në teknologjinë informative dhe komunikuese.

Aplikimi do të zgjasë deri më 31 mars, ndërkohë studentët mund të aplikojnë përmes adresës elektronike të kësaj organizate. Juria, e cila do të bëjë përzgjedhjen e tyre, do të përbëhet nga gjyqtarë, prokurorë, biznesmen dhe ekspertë të lëmenjve përkatës.

Gara do të mbahet më 10-11 maj. ■